



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 6/6 Prot

Vlorë, më 07 . 06 . 2022.

VENDIM

Nr.6, datë 31.05.2022

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJITJE, TË P.F “FERMER KRISTAQ BASHO”, ME
VENDNDODHJE: FSHATI ANDON POÇI, BASHKIA GJIROKASTËR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të Personit Fizik “Fermer Kristaq Basho”, “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje (në rastin kur përdorimi është për ≤ 5 ha, ≤ 5 l/sek)”, me vendndodhje: Fshati Andon Poçi, Njësia Administrative Odrie, Bashkia Gjirokastrë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Akuiferi Mollasik Miocenik i Burdigalianit

Koordinatat e vendndodhjes së burimit (KRGJSH)

X=510252.08; Y=4449592.69; Z=295 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.0324 l/sek

Sipërfaqja e parcelës që do të ujitet: S=0.56 ha

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)
X=508812.39; Y=4448082.07; Z=210 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)
X=508731.22; Y=4448309.42; Z=187 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: E papërfillshme, pothuajse 0 (zero).

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



KRYETARI

ELAMUR MAMAJ

Elmur Mamaj